Bluza e palosur duhet të vendoset në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen bluza të një numri dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë bluzash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e bluzës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese.

Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - LISTA E TESTIMEVE QË DUHET TË SHOQËROJNË OFERTËN TEKNIKE TË KËTIJ ARTIKULLI DHE REFERENCAT PËR METODAT E KRYERJES SË KËTYRE TESTIMEVE

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara
Masa gr/m ²	ISO 3801: 1977 / EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Qëndrueshmëria e ngjyrës	ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	ISO 12945-2: 2000 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	ISO 20471: 2013 Standardi për shiritat reflektivë dhe veshjet për sigurinë në punë.

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Bluzë me mëngë të shkurtra për punonjësit me shërbim pranë plazheve

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *bluzë me mëngë të shkurtra* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	e bardhë
	materiali 2**	e bardhë
Përbërja % (± 5%)	95% pambuk	5% poliestër
Thurja (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	pique (syth irlandez)
	materiali 2**	punim llastik 1:1
Masa gr/m ² (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës) (± 5%)	materiali 1*	250 gr/m ²
	materiali 2**	350 gr/m ²
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4—5 (Shkalla Gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 10000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4—5	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* — nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* — nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* — nota 6: *shumë e mirë*.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit bluzë me mëngë të shkurtra:

Frazelinë			
Shtresë termoadezive prej frazeline për përforcimin e bordurës së kopsave dhe vrimave.	Fortësi	e lehtë	
	Pesha e përafërt	80gr/m²	
	Përbërja	100% pambuk	
	Ngjyra	e bardhë	
Frazelinë për qepjen e elementëve <i>Velcro</i> . Frazelina duhet të jetë e përshtatshme për tekstilin e bluzës.			
Aksesorë të tjerë			
Fileto për përforcimin e bashkimit të jakës me trupin.	Përbërja	100% pambuk.	
	Trashësia	1 cm	
	Ngjyra	e bardhë (njësoj me materialin 1)	
Element <i>Velcro</i> femër për vendosjen e numrit të identifikimit/shenjës se mbiemrit dhe elementë <i>Velcro</i> me formën e stemës dhe shenjave që do të vendosen tek mëngët e bluzës.	Përmasat <i>Velcro</i> të gjoksit (2 copë)		86 x 30 mm
	Përmasat <i>Velcro</i> të mëngëve (2 copë)		70 x 80 mm
	Përbërja		100% fibra poliamide
	Trashësia		2.2 mm
	Masa lineare		41 g/m ± 5 %
	Ngjyra		njësoj si bluza
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30 °C
	E nxehtë		pika e dobësimit: 180 °C
			pika e shkrirjes: 210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje		jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Filli			
Fill qepës i përshtatshëm për të gjitha qepjet e trikotazhit (përfshi vrimat e kopsave).	Përbërja		100% poliester
	Dëndësia lineare		120 X 2 dTex
	Qëndrueshmëria në tërheqje		jo më pak se 12 N
	Zgjatueshmëria		≥ 15%
	Ngjyra		njësoj si tekstilet
Kopsat			
Kopsa plastike	3 copë Nr. 18 (d 11 mm) + 1 rezervë		
	Lloji		me 4 vrima
	Ngjyra e kopsës		e bardhë
	Materiali		100% poliester

	Gdhendje në kopsë	POLICIA E SHTETIT
	Ngjyra e shkrimit	njësoj si kopsa
	Lloji i gërmës (font)	Myriad pro, bold
	Qepja e kopsës	Kryq
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

c. Proces stampimi mbi artikullin *bluzë me mëngë të shkurtra*:

Stampat		
Shkrimi POLICIA, përpara 	Ngjyra	blu (classic blue)
	Përmasat	8.6 x 1.7 cm
	Lloji i gërmës	Myriad Pro Bold
Shkrimi POLICIA, mbrapa Për meshkuj, masa M 	Ngjyra	blu (classic blue)
	Përmasat për meshkujt	35 x 7 cm
	Lloji i gërmës	Myriad Pro Bold
Shkrimi POLICIA, mbrapa Për femra, masa M 	Ngjyra	blu (classic blue)
	Përmasat për femra	28 x 5.7 cm
	Lloji i gërmës	Myriad Pro Bold

d. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *bluzë me mëngë të shkurtra*:

1 qese polietileni për paketimin e bluzës
1 kuti kartoni për ruajtjen e bluzave

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli bluzë me mëngë të shkurtra do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS–XXXL për femrat dhe S–XXXL për meshkujt dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.	9	Distanca mes gjokseve	cm.
14	Gjatësia nga supi në brryl	cm.	10	Perimetri i muskulit të krahut	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.	12	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.
16	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
	Gjatësia e supit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
			25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra e bardhë për tekstin e kryesor të bluzës, jakës dhe elementëve *Velcro*.
Ngjyra e blu e çelët për stampat në bluzë.
Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

***Kujdes!** Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.*

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit bluzë me mëngë të shkurtra.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të gjatësisë së sythave.

Relaksimi i tekstileve të trikotuara

Tekstili i trikotuar duhet të qëndrojë i shtrirë për 24 orë para se të kalojë në procesin e prerjes.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 60 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën dhe kohëzgjatjen e caktuar për materialin përkatës. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet ngjitja e frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I BLUZËS

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të bluzës me mëngë të shkurtra.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Për femra



Për meshkuj



Bluzat me mëngë të shkurtra për femra dhe për meshkuj janë njësoj në tekstil dhe ngjyrë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë sipas gjinisë përkatëse dhe kopsave: femrat në të majtë, meshkujt në të djathtë.

Pjesët përbërëse të bluzës:

- Jaka
- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme (shpina)
- Dy mëngë të shkurtra
- Dy shirita elastik të mëngëve

*Bluzë me mëngë të shkurtra për punonjëset
e Policisë së Shtetit me shërbim
pranë plazheve*



*Bluzë me mëngë të shkurtra për punonjësit
e Policisë së Shtetit me shërbim
pranë plazheve*



JAKA

Jaka duhet të ndërtohet me tekstil trikotazh methurje llastik 1:1 me drejtim vertikal dhe lartësi standarde 8 cm.

Bashkimi i dy pjesëve të bluzës duhet të bëhet me anë të një filetoje prej pambuku me gjerësi rreth 1 cm. Qepja e filetos tek jaka dhe tek bluza duhet të bëhet me dy tegela linearë një gjilpërësh. Ajo duhet të fillojë dhe të mbarojë tek gjysma e gjerësisë së bordurave të kopsave dhe vrimave të kopsave.



Bordura e kopsave të masës M për meshkujt duhet të ketë përmasa 3.5 x 14 cm, ndërsa për femrat 2.5 x 13 cm.

Bordura e vrimave dhe e kopsave duhet të jenë të dyja të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Në pjesën e poshtme bordurat duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me një qepje në formë drejtkëndore me përmasa 3.5 x 1 cm për meshkujt dhe 2.5 x 1 cm për femrat.

Tek meshkujt kopsat duhet të jenë në anën e djathtë ndërsa tek femrat kopsat duhet të jenë në anën e majtë. Ato duhet të jenë Nr. 18 (11 mm). Qepja e tyre duhet të bëhet kryq me fill me ngjyrë të bardhë.

Vrima e parë e kopsës duhet të jetë me drejtim horizontal. Ajo duhet të hapet në një distancë 1 cm nga buza e sipërme e bordurës. Vrimat e tjera duhet të jenë me drejtim vertikal dhe të baraslarguara me një distancë 4.5 cm nga njëra-tjetra. Vrimat e kopsave duhet të kenë gjatësi 18 mm.

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Si përpara ashtu edhe mbrapa bluza duhet të ndërtohet me nga një pjesë të vetme.


Pjesa e përparme edhe ajo e pasme duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh të përforcuar nga brenda me tegel syzator.

Pjesa e përparme e plotë dhe ajo e pasme e plotë duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh të përforcuar nga brenda me tegel syzator.

Në linjën e supeve duhet qepur një fileto përforcuese për ruajtjen e formës së supeve.

Midis shpatullave të bluzës së meshkujve, në brendësi, duhet të qepet një shtresë përforcuese në formën e gjysmë rrethit me të njëjtin tekstil si bluza. Rrezja e rrethit duhet të jetë rreth 9 cm. Përmasa e saktë e rrethit duhet të ndryshojë sipas masës së bluzës.

Në fund bluza duhet të



mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2.5 cm. Palosja duhet të qepet me tegel syzator dy gjilpërësh.

Pjesët “e çara” duhet të jenë të larta 4 cm dhe duhet të përforcohen me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor nga secila anë e buzës.

Fundi i bluzës duhet të jetë i drejtë dhe duhet të ketë të njëjtën gjatësi në të dyja anët.



E çara anësore në bluzë

MËNGËT

Mëngët duhet të përbëhen nga një pjesë të vetme tekstili.

Përmasat e mëngës duhet të ndryshojnë në varësi të masës së bluzës.

Mënga duhet të bashkohet me trupin e bluzës me 2 tegela: 1 tegel qepës linear dhe 1 tegel syzator 5 gjilpërësh.


Mënga duhet të mbyllet me tekstil trikotazh methurje “llastik” 1:1 me drejtim vertikal (i njëjtë me atë të jakës) me lartësi rreth 3 cm.

Tekstili trikotazh duhet të bashkohet me mëngën me tegel linear dy gjilpërësh dhe të përforcohet nga brenda me tegel syzator.

Përmasa të pandryshueshme për të gjitha masat e bluzës për femra dhe për meshkuj	
Lartësia e jakës	8 cm
Lartësia e shiritit llastik të mëngës	3 cm
Madhësia e çarjeve	4 cm
Lartësia e kthimit të palës së fundit të bluzës	2.5 cm

APLIKIMI I STAMPAVE DHE VELCRO

SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA




Në pjesën e pasme të bluzës, në shpinë, duhet të vendoset shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në një distancë rreth 10 cm poshtë jakës.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Gjatë përdorimit të bluzës stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

SHKRIMI “POLICIA”, PËRPARA



Në pjesën e përparme të bluzës, në anën e djathtë të gjoksit, duhet të stampohet fjala POLICIA. Stampa duhet të pozicionohet 1 cm mbi elementin *Velcro* në të djathtë.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Gjatë përdorimit të bluzës stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Gjatë përdorimit të bluzës stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

Përmasat e shkrimit të vogël duhet të jenë për të dyja gjinitë njësoj, 8.6 x 1.7 cm.

ELEMENTËT VELCRO


Bluza duhet të pajiset me 4 elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit, me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë për numrin e identifikimit, me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e stemës së policisë në mëngën e majtë.
- 1 copë me përmasa 8 x 7 cm për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë.


Elementët *Velcro* në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlarguar nga bordura e kopsave. Elementi *Velcro* për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë të bardhë dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

Kujdes!! Elementët *Velcro* për mëngën e djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryen punonjësi i policisë. Përmasat e *Velcro* kanë tolerancë ± 1 mm.



Velcro femër, për stemën e policisë në krahun e majtë.
Përmasat 8 x 7 cm



Velcro femër për shenjat e shërbimit në krahun e djathtë.
Përmasat 8 x 7 cm


6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së bluzës duhet të jenë me hap 30 shpime në 5 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e bluzës duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e bluzave është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Qepja e kopsave në bluzë duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Kopsat plastike duhet të qepen me drejtim vertikal dhe shkrimi POLICIA E SHETIT duhet të qëndrojë gjithmonë lart.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Bluza duhet të pajiset me 1 etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të bluzës, në anën e majtë, rreth 12 cm nga fundi i bluzës. Po në këtë etiketë duhet të vendoset edhe kopsa rezervë.

Bluza duhet të paloset duke e vendosur njërën nga mëngët në brendësi dhe tjetra përpara. Shiko foton për referencë



Bluza e palosur duhet të vendoset në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen bluza të një numri dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë bluzash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e bluzës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjites (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Qëndrueshmëria e ngjyrës	ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	ISO 12945-2: 2000 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Pulovër i trikotuar me jakë "V"

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *pulovër i trikotuar me jakë "V"* duhet të jetë icilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka)	materiali 1*	blu e errët
	materiali 2**	blu e errët
Përbërja % ($\pm 5\%$)	50% Lesh	50% Akrilik
Thurja (*trupi; **jaka)	materiali 1*	Interlock
	materiali 2**	punim llastik 1:1
Masa gr/m ² (*trupi; **jaka)($\pm 5\%$)	materiali 1*	550 gr/m ²
	materiali 2**	600 gr/m ²
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5	

b. Materiali i dytë bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *pulovër i trikotuar me jakë "V"* duhet të jetë i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue)	
Përbërja % ($\pm 5\%$)	50% Pambuk	50% Poliester
Thurja	Diagonal	
Masa gr/m ² ($\pm 5\%$)	250 gr/m ²	
Dendësia	B= 300 fije/ 10 cm	Indi= 200 fije/10cm
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e dy tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4* dhe *shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

c. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *pulovër i trikotuar me jakë "V"*:

Përforcues		
Shtresë termoadezive prej frazeline për përforcimin e spaletave.	Fortësi	Mesatare
	Pesha e përafërt	80gr/m ²
	Përbërja	100% pambuk
	Ngjyra	e errët
Frazelinë për qepjen e elementëve <i>Velcro</i> . Frazelina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e pulovrit.		
Aksesorë të tjerë		
Element <i>Velcro</i> femër për vendosjen e numrit të identifikimit/shenjës së mbiemrit dhe elementë <i>Velcro</i> me formën e stemës dhe shenjave që do të vendosen tek mëngët e pulovrit.	Përmasat <i>Velcro</i> të gjoksit (1 copë)	86 x 30 mm
	Përmasat <i>Velcro</i> të mëngëve (2 copë)	70 x 80 mm
	Përbërja	100% fibra poliamide
	Trashësia	2.2 mm
	Masa lineare	41 g/m ± 5%
	Ngjyra	njësoj si pulovri
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme	
	E ftohtë	- 30 °C
	E nxehtë	pika e dobësimit: 180 °C
		pika e shkrirjes: 210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës	
	Në larje	jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë	
	Në djersë	
	Në fërkim	

Filli		
Fill qepës i përshtatshëm për të gjitha qepjet e trikotazhit (përfshi vrimat dhe velcro).	Përbërja	100% poliestër
	Numri:	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si tekstilet
Kopsat		
Kopsa plastike për spaletat 	2 copë me diametër (d 15 mm) + 1 rezervë	
	Lloji	me 4 vrima
	Ngjyra e kopsës	Blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	kryq
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

d. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *pulovër i trikotuar me jakë "V"*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2.MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikullipulovër i trikotuar me jakë "V" do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS–XXXL për femrat dhe S–XXXL për meshkujt dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.	9	Distanca mes gjokseve	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.	10	Perimetri i muskulit të krahut	cm.
14	Gjatësia nga supi në brryl	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.	12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
16	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
	Gjatësia e supit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
			25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e tekstilit të pulovrit, punimit elastik dhe elementëve *Velcro* femër duhet të jetë blu e errët.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit pulovër i trikotuar me jakë "V".

Përgatitja e fijeve për prodhimin e pulovrit në makineri trikotazhi

Filli për prodhimin e pulovrit duhet të jetë i njëtrajtshëm në strukturë dhe në ngjyrë. Ai duhet të jetë i lyer me ngjyrën e specifikuar në këtë dokument. Filli duhet të jetë i cilësisë së parë dhe të mos pësojë dëmtime gjatë proceseve të tjera përgatitore.


Përgatitja e modelit

Modelimi i pulovrit duhet të kryhet me anë të programeve kompjuterike të përshtatshme për operimin e makinerive të trikotazhit.

Prodhimi

Prodhimi i pulovrit të trikotuar duhet të bëhet sipas skemës së mëposhtme.

Nuk do të pranohet asnjë skemë tjetër prodhimi e pa aprovuar më parë nga specialistët teknikë pranë Policisë së Shtetit përveç kësaj që është përshkruar në këtë dokument.



Tekstili i trikotuar duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme për secilin nga treguesit e specifikuar:

Treguesi për butësinë e tekstilit të trikotuar

E ashpër	Mesatare	E butë
----------	----------	--------

Treguesi për trashësinë e tekstilit të trikotuar

I trashë	Mesatar	I hollë
----------	---------	---------

Treguesi për elasticitetin e tekstilit të trikotuar


Pa elasticitet	Mesatar	Shumë Elastike
----------------	---------	----------------

Produkti i përfunduar duhet të kalojë nëpërmjet procesit të relaksimit të trikotazhit, që nënkupton larjen dhe fiksimin me avull sipas kushteve teknike të tekstilit.


5. NDËRTIMI I PULOVKIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të pulovrit të trikotuar.



Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Pulovër me jakë "V" për femra



Pulovër me jakë "V" për meshkuj



Pulovri duhet të ndërtohet me anë të makinerive të trikotazhit.
 Filli duhet të ketë përbërje të përzierë leshi dhe akriliku.
 Jaka e pulovrit duhet të jetë "V".
 Pjesët përbërëse të pulovrit:

- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Mëngët e gjata
- Dy spaleta
- Dy pjesët e tekstilit që duhet të qepen në pjesën e supeve
- Dy pjesët e tekstilit që duhet të qepen tek mëngët
- Një xhep që duhet të qepet në mëngën e majtë

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Pjesa e përparme dhe e pasmeduhettë ndërtohet plota (pa prerje), me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 7cm e para dhethurje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër.

Thurja llastik 1:1 duhet të jetë elastike dhe të mos zgjerohet apo deformohet gjatë përdorimit.

Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelit syzator pesëfijesh.

Pulovri duhet të jetë i gjatë deri sipër vitheve (pika 5 në skemën e matjeve).



JAKA

Bordura e jakës duhet të ndërtohet me punim trikotazhi methurje llastik 1:1.

Gjerësia e bordurës së jakës duhet të jetë 2.5 cm për meshkujt dhe 2 cm për femrat. Gjatësia e brinjës së trekëndëshit të bordurës së jakës duhet të jetë 18cm. Bordura e jakës duhet të jetë bashkuar dhe e palosur me trupin e pulovrit me anë të makinerive të posaçme të trikotazhit.



Kujdes! Përmasat e hapjes së jakës mund të ndryshojnë tek masat e mëdha dhe të vogla.


MËNGËT E GJATA

Mëngë e gjata duhet të ndërtohen të plota (pa prerje), me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 7cm e para dhethurje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër. Mëngët duhet të qepen me trupin me anë të tegelit syzator pesëfijesh.



Përmasa të pandryshueshme për të gjitha masat e pulovrave	
Lartësia e punimit llastik në fund të pulovrit	7 cm
Lartësia e punimit llastik në fund të mëngës	7 cm

SPALETAT



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërin anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 1 mm nga buza.

Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu të tezgjahuar me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive.


Në anën e “shigjetës”, në distancë rreth 1.5 cm nga maja, duhet të hapet një vrimë kopsë horizontale me gjatësi 20 mm. Një kopsë plastike me diametër 15 mm duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i pulovrit.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë sipas masës së pulovrit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2 – 3 mm për çdo masë. Dimensionet bazë duhet të jenë këto: 12 x 4.8 cm për masën më të vogël të pulovrit dhe 15 x 4.8 cm për masën më të madhe të pulovrit

Aksi qendror gjatësor i spaletës duhet të përputhet me linjën e supit.

“ARNAT” E SUPEVE


Arnat duhet të kenë formë drejtkëndore dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë sipas masës së pulovrit. Për pulovrin e meshkujve masa M, përmasat e arnës duhet të jenë 11/12x28cm. Për pulovrin e femrave masa M, përmasat e arnës duhet të jenë 9/10x24 cm. Arnat duhet të jenë me tekstiltezgjahume përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.



Arnat duhet të vendosen tek linja e supeve. Buza e arnës duhet të ketë një palosje të brendshme rreth 6mm në të gjitha anët. Njëra anë duhet të qepet tek tegeli qepës i mëngës ndërsa anët e tjera duhet të përshkohen nga dy tegela lineare një gjilpërësh me distancë 1mm dhe 6mm nga buza.

Kopsat e spaletave duhet të qepen tek arnat. Ato duhet të qepen në linjën e supeve, në një distancë distancë ± 2 cm nga bordura e jakës. Kopsat duhet të jenë plastike me 4 vrima me diametër 15mm. Qepja e kopsave duhet bërë kryq.


Ylyk prej tekstili. Në anën e përparme të arnës së djathtë duhet vendoset një ylyk me përmasa 1,5cm x 2,5 cm (i papalosur 1,5 cm x 6 cm).



ARNAT E MËNGËVE

Në pjesën e pasme të parakrahëve duhet të qepen arnat me formë drejtkëndore me kulme të rrumbullakosura. Përmasat e arnave duhet të jenë 11cm x 26cm. Ato duhet të qepen në një distancë rreth 10 cm larg nga punimi llastik i mëngës dhe të arrijnë deri tek brrylat. Përmasat e arnave duhet të janë standarde për të gjitha masat e pulovrave për meshkuj dhe për femra.

Arnat duhet të jenë me tekstil tezgjahu me përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.



XHEPI I MËNGËS


Pulovrat për femra dhe meshkuj duhet të kenë nga një xhep me formë drejtkëndore të qepur në mëngën e majtë. Xhepi duhet të ketë dy ndarje vertikale me gjerësi 3cm secila dhe duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili të mbivendosura me këto përmasa:

Shtresa e parë	Shtresa e dytë
lartësi 13.5 cm	lartësi 11cm
gjerësi 7.5 cm	gjerësi 7.5 cm

Buzët e të dyja shtresave duhet të kenë një palosje të brendshme në të gjitha anët dhe të përshkohen nga dy tegela lineare një gjilpërësh me distancë 1mm dhe 6mm nga buza.

Shtresa e dytë duhet ta ketë tegelin e buzës së sipërme të qepur vetëm me palosjen ndërsa tre anët e tjera duhet të qepen me shtresën e parë dhe tekstilin e pulovrit.

Xhepi duhet të qepet me të njëjtin tekstil si arnat.



ELEMENTËT VELCRO

Pulovri duhet të pajiset me 4 elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit me përmasa 86 x 30 mm.
- 1 copë për vendosjen e numrit të identifikimit me përmasa 86 x 30 mm.
- 1 copë me formën e stemës së policisë, e montuar në mëngën e majtë me përmasa 70 x 80 mm.
- 1 copë për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë me përmasa 70 x 80 mm.


Elementët *Velcro* në pjesën e përparme duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlanguar nga jaka e pulovrit.

Elementi *Velcro* në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel zig-zag perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale.

Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

Kujdes! Elementët *Velcro* për mëngën e djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryenpunonjësi i policisë. Kufiri i lejuar i gabimit për elementët *Velcro* është $1\text{ mm} \pm$.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara në këtë specifikim teknik.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrikë, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e pulovrit duhet të jetë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstileve për të ruajtur formën pas lëshimit nga makina e trikotazhit, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstili i trikotuar nuk duhet të lahet ose hekuroset në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili i trikotuar nuk duhet të pësojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Të dhënat e mirëmbajtjes së tekstit të trikotuar duhet të jenë si mëposhtë:
 - Larja në 40°C me centrifugë jo të fortë.
 - Mund të pastrohet në pastrim kimik në të thatë.
 - Nuk pranon trajtimin me klor apo zbardhues të tjerë.
 - Tekstili nuk pranon tharjen me tambur (makinë tharëse) dhe temperaturë të lartë.
 - Veshja nuk duhet të thahet afër burimeve me temperaturë të lartë si p.sh. kalorifer, etj.
 - Hekurose me avull në temperaturë maksimale 110°C
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e pulovrave është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Pulovriduhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në brendësi të pulovrit, në anën e majtë, rreth 12 cm nga fundi. Po në këtë etiketë duhet të vendoset edhe kopsa rezervë.

Pulovri duhet të paloset duke e vendosur njërën nga mëngët në brendësi dhe tjetra përpara. Shiko foton për referencë.



Pulovrii palosur duhet të vendoset në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen pulovra të një masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë pulovrash. Qeset me pulovra duhet të vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me adeziv (ngjitës).

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e pulovrit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801: 1977 / EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Dendësia	ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodot e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline

	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	ISO 12945-2: 2000 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Pulovër i trikotuar me jakë rrumbullake

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *pulovër i trikotuar* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka)	materiali 1*	blu e errët
	materiali 2**	blu e errët
Përbërja % (± 5%)	50% Lesh	50% Akrilik
Thurja (*trupi; **jaka)	materiali 1*	Interlock
	materiali 2**	punim llastik 1:1
Masa gr/m ² (*trupi; **jaka) (± 5%)	materiali 1*	550 gr/m ²
	materiali 2**	600 gr/m ²
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5	

b. Materiali i dytë bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *pulovër i trikotuar* duhet të jetë i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue)	
Përbërja % (± 5%)	50% Pambuk	50% Poliester
Thurja	Diagonal	
Masa gr/m ² (± 5%)	250 gr/m ²	
Dendësia	B= 300 fije/ 10 cm	Indi= 200 fije/10cm
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e dy tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë do të fërkohej për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

c. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *pulovër i trikotuar*:

Filli		
Fill qepës i përshtatshëm për të gjitha qepjet e trikotazhit (përfshi dhe vrimat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri:	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si tekstilet
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

d. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *pulovër e trikotuar për femra dhe meshkuj*, për punonjësit e *Policisë së Shtetit* janë:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



1 qese polietileni për paketimin e pulovrit

1 kuti kartoni për ruajtjen e pulovrave

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *pulovër i trikotuar* do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS–XXXL për femrat dhe S–XXXL për meshkujt dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskullit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.	9	Distanca mes gjokseve	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.	10	Perimetri i muskullit të krahut	cm.
14	Gjatësia nga supi në brryl	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.	12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
16	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.

Gjatësia e supit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
		19	Gjatësia e supit	cm.
		20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
		25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e tekstilit të pulovrit dhe punimit llastik duhet të jetë blu e errët.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.

***Kujdes!** Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.*



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit pulovër i trikotuar.

Përgatitja e fijeve për prodhimin e pulovrit në makineri trikotazhi

Filli për prodhimin e pulovrit duhet të jetë i njëtrajtshëm në strukturë dhe në ngjyrë. Ai duhet të jetë i lyer me ngjyrën e specifikuar në këtë dokument. Filli duhet të jetë i cilësisë së parë dhe të mos pësojë dëmtime gjatë proceseve të tjera përgatitore.


Përgatitja e modelit

Modelimi i pulovrit duhet të kryhet me anë të programeve kompjuterike të përshtatshme për operimin e makinerive të trikotazhit.

Prodhimi

Prodhimi i pulovrit të trikotuar duhet të bëhet sipas skemës së mëposhtme.

Nuk do të pranohet asnjë skemë tjetër prodhimi e pa aprovuar më parë nga specialistët teknikë pranë Policisë së Shtetit përveç kësaj që është përshkruar në këtë dokument.



Tekstili i trikotuar duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme për secilin nga treguesit e specifikuar:

Treguesi për butësinë e tekstilit të trikotuar

E ashpër	Mesatare	E butë
----------	----------	---------------

Treguesi për trashësinë e tekstilit të trikotuar

I trashë	Mesatar	I hollë
----------	----------------	---------

Treguesi për elasticitetin e tekstilit të trikotuar

Pa elasticitet	Mesatar	Shumë Elastike
----------------	---------	-----------------------

Produkti i përfunduar duhet të kalojë nëpërmjet procesit të relaksimit të trikotazhit, që nënkupton larjen dhe fiksimin me avull sipas kushteve teknike të tekstilit.


5. NDËRTIMI I PULOVRIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të pulovrit të trikotuar.


Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

Pulovër me jakë rrumbullake


për femra





për meshkuj



Pulovër me jakë rrumbullake për femra



Pulovër me jakë rrumbullake për meshkuj



Pulovëri duhet të ndërtohet me anë të makinerive të trikotazhit.
 Filli duhet të ketë përbërje të përzierë leshi dhe akriliku.
 Jaka e pulovrit duhet të jetë rrumbullake.
 Pjesët përbërëse të pulovrit:

- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Mëngët e gjata
- Dy pjesët e tekstilit që duhet të qepen në pjesën e supeve
- Dy pjesët e tekstilit që duhet të qepen tek mëngët

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të ndërtohen të plota (pa prerje) me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 7 cm e para dhe theurje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër.

Thurja llastik 1:1 duhet të jetë elastike dhe të mos zgjerohet apo deformohet gjatë përdorimit.

Pulovëri duhet të jetë i gjatë deri sipër vitheve (pika 5 në skemën e matjeve).
 Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelit syzator pesëfijesh.



JAKA

Bordura e jakës duhet të ndërtohet me punim trikotazhi methurje llastik 1:1.

Gjerësia e bordurës së jakës duhet të jetë 2.5 cm për meshkujt dhe 2 cm për femrat. Jaka rrumbullake, duhet të jetë e ngushtë pas qafës.
 Bordura e jakës duhet të jetë e bashkuar dhe e palosur me trupin e pulovrës me anë të makinerive të posaçme të trikotazhit.



Kujdes! Hapja e jakës mund të ndryshojnë tek masat e mëdha dhe të vogla.

MËNGËT E GJATA


Mëngë e gjata duhet të ndërtohen të plota (pa prerje), me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 7 cm e para dhe theurje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër. Mëngët duhet të qepen me trupin me anë të tegelit syzator pesëfijesh.



Përmasa të pandryshueshme për të gjitha masat e pulovrave	
Lartësia e punimit llastik në fund të pulovrit	7 cm
Lartësia e punimit llastik në fund të mëngës	7 cm

“ARNAT ” PREJ TEKSTILI NË SUPE

Arnat duhet të kenë formë drejtkëndore dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë sipas masës së pulovrit. Për pulovrin e meshkujve masa M, përmasat e arnës duhet të jenë 11/12 x 28 cm. Për pulovrin e femrave masa M, përmasat e arnës duhet të jenë 9/10 x 24 cm. Arnat duhet të jenë me tekstil tezgjahu me përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.




Arnat duhet të vendosen tek linja e supeve. Buza e arnës duhet të ketë një palosje të brendshme rreth 6 mm në të gjitha anët. Njëra anë duhet të qepet tek tegeli qepës i mëngës ndërsa anët e tjera duhet të përshkohen nga dy tegela lineare një gjilpërësh me distancë 1 mm dhe 6 mm nga buza.

ARNAT PREJ TEKSTILI NË MËNGË

Në pjesën e pasme të parakrahut duhet të qepen dy arna me formë drejtkëndore me kulme të rrumbullakosura. Përmasat e arnave duhet të jenë 11 cm x 26 cm. Ato duhet të qepen në një distancë rreth 10 cm larg nga punimi i lastik i mëngës dhe të arrijnë deri tek brrylat. Përmasat e arnave duhet të janë standarde për të gjitha masat e pulovrave për meshkuj dhe për femra.

Arnat duhet të jenë me tekstil tezgjahu me përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara në këtë specifikim teknik.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrikë, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e pulovrit duhet të jetë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstileve për të ruajtur formën pas lëshimit nga makina e trikotazhit, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstili i trikotuar nuk duhet të lahet ose hekuroset në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili i trikotuar nuk duhet të pësojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Të dhënat e mirëmbajtjes së tekstit të trikotuar duhet të jenë si mëposhtë:
 - Larja në 40°C me centrifugë jo të fortë.
 - Mund të pastrohet në pastrim kimik në të thatë.
 - Nuk pranon trajtimin me klor apo zbardhues të tjerë.
 - Tekstili nuk pranon tharjen me tambur (makinë tharëse) dhe temperaturë të lartë.
 - Veshja nuk duhet të thahet afër burimeve me temperaturë të lartë si p.sh. kalorifer, etj.
 - Hekurose me avull në temperaturë maksimale 110°C
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e pulovrave është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Pulovri duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në brendësi të pulovrit, në anën e majtë, rreth 12 cm nga fundi.

Pulovri duhet të paloset duke e vendosur njërën nga mëngët në brendësi dhe tjetra përpara. Shiko foton për referencë.



Pulovri i palosur duhet të vendoset në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen pulovra të një masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë pulovrash. Qeset me pulovra duhet të vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me adeziv (ngjitës).

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e pulovrit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801: 1977 / EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Dendësia	ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline

	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	ISO 12945-2: 2000 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Pulovër me jakë gjysëm golf

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *pulovër me jakë gjysëm golf* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka)	materiali 1*	blu e errët
	materiali 2**	blu e errët
Përbërja % ($\pm 5\%$)	50% Lesh	50% Akrilik
Thurja (*trupi; **jaka)	materiali 1*	Interlock
	materiali 2**	punim llastik 1:1
Masa gr/m ² (*trupi; **jaka) ($\pm 5\%$)	materiali 1*	550 gr/m ²
	materiali 2**	600 gr/m ²
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *pulovër me jakë gjysëm golf*:

Tekstile			
Tekstil për arnat e mëngëve	Ngjyra	blu e errët (evening blue)	
	Përbërja % (±5%)	50% Pambuk	50% Poliester
	Thurja	Diagonal	
	Pesha gr/m²(±5%)	250 gr/m²	
Përforcues			
Frazelinë për qepjen e elementëve <i>Velcro</i> . Frazelina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e pulovrit.			
Aksesorë të tjerë			
Element <i>Velcro</i> femër për vendosjen e numrit të identifikimit/shenjës së mbiemrit dhe elementë <i>Velcro</i> me formën e stemës dhe shenjave që do të vendosen tek mëngët e pulovrit. 	Përmasat <i>Velcro</i> të gjoksit (2 copë)		86 x 30 mm
	Përmasat <i>Velcro</i> të mëngëve (2 copë)		70 x 80 mm
	Përbërja		100% fibra poliamide
	Trashësia		2.2 mm
	Masa lineare		41 g/m ± 5%
	Ngjyra		njësoj si pulovri
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30 °C
	E nxehtë		pika e dobësimit: 180 °C
			pika e shkrirjes: 210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje		jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Filli			
Fill qepës i përshtatshëm për të gjitha qepjet e trikotazhit (përfshi vrimat dhe velcro).	Përbërja		100% poliester
	Numri:		80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje		jo më pak se 12 N
	Ngjyra		njësoj si tekstilet
Zinxhir			
	Zinxhir i përshtatshëm për trikotazhe.		
	Shirit i zinxhirit		100% poliester
	Dhëmbët e zinxhirit		100% nikel
	Ngjyra	Shirit	blu e errët
		Dhëmbët	argjend

Etiketa		
Etiketë prej tekstili për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e bardhë

d. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *pulovër me jakë gjysëm golf*:

1 qese polietilene për paketimin epulovrit
1 kuti kartoni për ruajtjen e pulovrave

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuar.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikullipulovër me jakë gjysëm golf do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS–XXXL për femrat dhe S–XXXL për meshkujt dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	Cm	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.

12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.	9	Distanca mes gjokseve	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.	10	Perimetri i muskulit të krahut	cm.
14	Gjatësia nga supi në brryl	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.	12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
16	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
	Gjatësia e supit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
			25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e tekstilit të pulovrit, punimit llastik dhe elementëve *Velcro* femër duhet të jetë blu e errët.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.

***Kujdes!** Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.*

PANTONE®
19-3815 TCX
Evening Blue

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *pulovër me jakë gjysëm golf*.

Përgatitja e fijeve për prodhimin e pulovrit në makineri trikotazhi

Filli për prodhimin e pulovrit duhet të jetë i njëtrajtshëm në strukturë dhe në ngjyrë. Ai duhet të jetë i lyer me ngjyrën e specifikuar në këtë dokument. Filli duhet të jetë i cilësisë së parë dhe të mos pësojë dëmtime gjatë proceseve të tjera përgatitore.



Përgatitja e modelit

Modelimi i pulovrit duhet të kryhet me anë të programeve kompjuterike të përshtatshme për operimin e makinerive të trikotazhit.

Prodhimi

Prodhimi i pulovrit të trikotuar duhet të bëhet sipas skemës së mëposhtme.

Nuk do të pranohet asnjë skemë tjetër prodhimi e pa aprovuar më parë nga specialistët teknikë pranë *Policiës së Shtetit* përveç kësaj që është përshkruar në këtë dokument.



Pjesa e jakës, llastik 1x1

Tekstili i trikotuar duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme për secilin nga treguesit e specifikuar:

Treguesi për butësinë e tekstilit të trikotuar

E ashpër	Mesatare	E butë
----------	----------	--------

Treguesi për trashësinë e tekstilit të trikotuar

I trashë	Mesatar	I hollë
----------	---------	---------

Treguesi për elasticitetin e tekstilit të trikotuar

Pa elasticitet	Mesatar	Shumë Elastike
----------------	---------	----------------


Produkti i përfunduar duhet të kalojë nëpërmjet procesit të relaksimit të trikotazhit, që nënkupton larjen dhe fiksimin me avull sipas kushteve teknike të tekstilit.

5. NDËRTIMI I PULOVRIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të pulovrit të trikotuar.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.





Pulovri duhet të ndërtohet me anë të makinerive të trikotazhit.
 Filli duhet të ketë përbërje të përzierë leshi dhe akriliku.
 Jaka e pulovrit duhet të jetë gjysëm golf,

Pjesët përbërëse të pulovrit:

- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Mëngët e gjata
- Dy pjesët e tekstilit që duhet të qepen tek mëngët

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të ndërtohen të plota, me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 7 cm e para dhe theurje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër.

Thurja llastik 1:1 duhet të jetë elastike dhe të mos zgjerohet apo deformohet gjatë përdorimit.

Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelit syzator pesëfijesh.

Pulovri duhet të jetë i gjatë deri sipër vitheve (pika 5 në skemën e matjeve).



JAKA

Jaka duhet të ndërtohet me punim trikotazhi methurje llastik 1:1. Jaka duhet të jetë e palosur në dysh dhe duhet të ketë lartësi rreth 7 cm.

Jaka duhet të jetë e bashkuar me trupin e pulovrit me anë të makinerive të posaçme për bashkimin e tekstileve të trikotuara.



Kujdes! Përmasat e hapjes së jakës mund të ndryshojnë tek masat e mëdha dhe të vogla.

ZINXHIRI

Pulovri duhet të jetë i pajisur me një zinxhir për mbylljen e jakës dhe pjesës së gjoksit. Zinxhiri duhet të jetë i përshtatshëm për tekstilet e trikotuara.




MËNGËT E GJATA

Mëngë e gjata duhet të ndërtohen të plota (pa prerje), me punim trikotazhi methurje llastik 1:1 në 7cm e para dhe theurje *interlock* në të gjithë pjesën tjetër. Mëngët duhet të qepen me trupin me anë të tegelit syzator pesëfijesh.

ARNAT E MËNGËVE

Në pjesën e pasme të parakrahëve duhet të qepen arnat me formë drejtkëndore me kulme të rrumbullakosura. Përmasat e arnave duhet të jenë 11cm x 26cm. Ato duhet të qepen në një distancë rreth 10 cm larg nga punimi llastik i mëngës dhe të arrijnë deri tek brrylat. Përmasat e arnave duhet të jenë standarde për të gjitha masat e pulovrave për meshkuj dhe për femra.

Arnat duhet të jenë me tekstil tezgjahu me përbërje të përzierë pambuku dhe poliestre.



Përmasa të pandryshueshme për të gjitha masat e pulovrave	
Lartësia e punimit llastik në fund të pulovrit	7 cm
Lartësia e punimit llastik në fund të mëngës	7 cm

ELEMENTËT VELCRO

Pulovri duhet të pajiset me 4 elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit me përmasa 86 x 30 mm.
- 1 copë për vendosjen e numrit të identifikimit me përmasa 86 x 30 mm.
- 1 copë me formën e stemës së policisë, e montuar në mëngën e majtë me përmasa 70 x 80 mm.
- 1 copë për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë me përmasa 70 x 80 mm.


Elementët *Velcro* në pjesën e përparme duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlarguar nga jaka e pulovrit.

Elementi *Velcro* në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel zig-zag perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale.

Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

Kujdes! Elementët *Velcro* për mëngën e djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryenpunonjësi i policisë. Kufiri i lejuar i gabimit për elementët *Velcro* është 1 mm±.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara në këtë specifikim teknik.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrikë, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e pulovrit duhet të jetë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstileve për të ruajtur formën pas lëshimit nga makina e trikotazhit, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstili i trikotuar nuk duhet të lahet ose hekuroset në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili i trikotuar nuk duhet të pësojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Të dhënat e mirëmbajtjes së tekstit të trikotuar duhet të jenë si mëposhtë:
 - Larja në 40°C me centrifugë jo të fortë.
 - Mund të pastrohet në pastrim kimik në të thatë.
 - Nuk pranon trajtimin me klor apo zbardhues të tjerë.
 - Tekstili nuk pranon tharjen me tambur (makinë tharëse) dhe temperaturë të lartë.
 - Veshja nuk duhet të thahet afër burimeve me temperaturë të lartë si p.sh. kalorifer, etj.
 - Hekurose me avull në temperaturë maksimale 110°C
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e pulovrave është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI


Pulovriduhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në brendësi të pulovrit, në anën e majtë, rreth 12 cm nga fundi. Po në këtë etiketë duhet të vendoset edhe kopsa rezervë.

Pulovri duhet të paloset duke e vendosur njërën nga mëngët në brendësi dhe tjetra përpara. Shiko foton për referencë.

Pulovri i palosur duhet të vendoset në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen pulovra të një masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë pulovrash. Qeset me pulovra duhet të vendosen më pas në kuti kartoni të mbyllura me adeziv (ngjitës).

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e pulovrit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).



ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara
Masa gr/m ²	ISO 3801: 1977 / EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Qëndrueshmëria e ngjyrës	ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.

Efekti pilling (kokërrzimi)	ISO 12945-2: 2000 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
-----------------------------	--

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

POLICIA E SHTEETIT

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Kapuç leshi

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kapuç leshi* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët	
Përbërja (± 5%)	50% akrilik	50% lesh
Thurja	Ilastik 1:1	
Masa gr/m ² (± 5%)	550 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill
Qëndrueshmëria ndaj rrezatimit UV	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 12,000 cikle	
Efekti pilling (kokerzimi)	nota 4-5	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e dy tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstilin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë ose kapërcim të sytheve,
- trashim të fijeve,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapuç leshi*:

Filli		
Fill qepës i përshtatshëm për qepjet e tekstileve të trikotuara.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm

Fill për qëndisjen e shkrimit POLICIA	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si tekstili
	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	120 Nm
	Ngjyra	e bardhë
Përforcues		
Frazelinë për mbrojtjen e tekstit të trikotuar gjatë qëndisjes së shkrimit POLICIA		
Etiketa		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese, masën, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *kapuç leshi*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



1 qese polietileni për paketimin e kapuçit

1 kuti kartoni për ruajtjen e kapuçave

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuar.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *kapuç leshi* do të porositet dhe do të prodhohet në masat M dhe L, në sasinë e përcaktuar nga Policia e Shtetit.

3. NGJYRA REFERENCE

Ngjyra blu për tekstilin e trikotuar dhe fillin qepës.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.



1. PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË PËR PRODHIMIN NË LINJË TRIKOTAZHI

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit kapuç leshi.

Përgatitja e fijeve për prodhimin e kapuçit në makineri trikotazhi

Filli për prodhimin e kapuçit duhet të jetë i njëtrajtshëm në strukturë dhe në ngjyrë. Ai duhet të jetë i lyer me ngjyrën e specifikuar në këtë dokument. Filli duhet të jetë i cilësisë së parë dhe të mos pësojë dëmtime gjatë proceseve të tjera përgatitore.

Përgatitja e modelit

Modelimi i kapuçit duhet të kryhet me anë të programeve kompjuterike të përshtatshme për operimin e makinerive të trikotazhit.

Prodhimi

Prodhimi i kapuçit të trikotuar duhet të bëhet sipas skemës së mëposhtme.

Nuk do të pranohet asnjë skemë tjetër prodhimi e pa aprovuar më parë nga specialistët teknikë pranë *Policiës së Shtetit* përveç kësaj që është përshkruar në këtë dokument.

Për prodhimin e kapuçit duhen patur parasysh treguesit e butësisë, trashësisë dhe elasticitetit të tekstilit. Shih figurën në të djathtë.

Produkti i përfunduar duhet t'i nënshtrohet procesit të relaksimit të trikotazhit: larja dhe fiksimi me avull sipas kushteve teknike të tekstilit.

Treguesi për butësinë e tekstilit të trikotuar

E ashpër	Mesatare	E butë
----------	----------	--------

Treguesi për trashësinë e tekstilit të trikotuar

I trashë	Mesatar	I hollë
----------	---------	---------


Treguesi për elasticitetin e tekstilit të trikotuar

Pa elasticitet	Mesatar	Shumë Elastike
----------------	---------	----------------

5. NDËRTIMI I KAPUÇIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kapuçit.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Kapuçi prej leshi duhet prodhuar me formë tubolare. Trikotazhi i kapuçit duhet të ketë elasticitet të lartë.

Pjesët përbërëse të kapuçit:

- Tekstili i trikotuar
- Fjala POLICIA

KAPUÇI

Kapuçi duhet të prodhohet me makineri trikotazhi tubolare, methurje llastik 1:1, i punuar me fill akriliku të përzier me lesh.

Kapuçi duhet të mbyllet në pjesën e sipërme me 6 qepje; dy përpara, dy mbrapa dhe dy tegela anësore. Filli i përdorur duhet të jetë i përshtatshëm për qepjen e tekstilit të trikotuar.

Punim tubolar

qepja e kapuçit



FJALA “POLICIA”

Fjala POLICIA duhet të qëndiset tek bordura e palosur, në ballë të kapuçit. Qëndisja duhet të bëhet me ndihmën e frazelinës së përshtatshme për qëndisje në tekstil të trikotuar. Frazelina duhet të ketë të njëjtat përmasa si qëndisja.

Fjala POLICIA	Gjerësi	12 cm
	Lartësi	3 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold
	Ngjyra	e bardhë


Përmasa reference	
Gjerësia	19.5 cm
Palosja	7 cm
Gjatësia	20 cm

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara në këtë specifikim teknik.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, elastikë dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kapuçit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikullit, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstileve për të ruajtur formën pas lëshimit nga makina e trikotazhit, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)

- Në varësi të llojit, tekstili i trikotuar nuk duhet të lahet ose hekuroset në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili i trikotuar nuk duhet të pësojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e produktit është $\pm 2\%$.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI



Kapuçi duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, lloji i artikullit, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Etiketa duhet të vendoset në tegelin qepës të mbylljes së kapuçit.

Në momentin e dorëzimit kapuçi duhet të jetë i pastër

dhe i rregullt. Ai duhet pakëtohet në një qese polietileni. Artikulli i paketuar duhet të vendoset nëpër kuti kartoni.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Thurja	ISO 8388:1998 Tekstile - Pëlhura të trikotuara
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977/ EN 12127:2005 Tekstilet - Pëlhurat - Përcaktimi i masës për njësi të sipërfaqes
Qëndrueshmëria e ngjyrës	ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit

	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	ISO 12947-2: 1998 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në abrazion me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	ISO 12945-2: 2000 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

KOLAUDIMI

Policia e Shtetit ka të drejtën që të garantojë cilësinë e produktit final nëpërmjet një mekanizmi kontrolli që quhet *kolaudim*. Kolaudimi përfshin këto masa:

1. Verifikimi i fletë-analizës së tekstileve.
2. Matjet dhe provat fizike të artikujve të plota ose elementëve individualë të tyre.
3. Krahasimin e rezultateve të matjeve me specifikat e përcaktuara në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*.

Vetëm pasi të jenë bërë të gjitha verifikimet përkatëse nga grupi i kontrollit të cilësisë dhe rezultatet të kenë dalë pozitive, siç është parashikuar në kontratë dhe në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*, *Policia e Shtetit* do të bëjë pranimin e produktit përfundimtar. Artikujt konsiderohen të pranuar vetëm kur plotësohen të gjitha kërkesat e *Specifikimeve Teknike*.

GARANCIA

Afati i garancisë duhet të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit mbi 2 vjet. Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike të specifikuara në këtë dokument, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e plotë të artikullit, pa pagesë, konform specifikimeve teknike në këtë dokument. Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë. Afati i garancisë fillon në momentin e kolaudimit.

AUTORËSIA

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë pronë e *Policisë së Shtetit* dhe mund të përdoren vetëm nga strukturat e këtij institucioni. Kopjimi dhe shumëfishimi i *Specifikimeve Teknike* të këtyre artikujve është i ndaluar.

Dokumenti i Specifikimeve Teknike të kapitullit Trikotazhe ka gjithsej 137 faqe.